



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.90/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së panos në objektin publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë.

#### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 06.06.2017, nga Lëvizjes Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017, në ndërtesën e Qendrës Studentore (konvikte) në Ulpianë, ishte vendosur pano e kandidatit për deputet Kadri Veseli nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, i cili ishte vërejtur nga aktivisti Drilon Pireva, diku rreth orës 17:00. Për këtë në kuptim të dispozitës së nenit 4.1, pikës b, të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4, të Rregullës Zgjedhore 13/2014, se vendosja e materialit zgjedhor brenda apo jashtë institucionit publik përbën veprim të ndaluar për subjektin politik, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Sipas kësaj koalicioni me vendosjen e panos në ndërtesën që është në pronësi publike si pjesë e Universitetit të Prishtinës, pra të konviktet e studentëve, ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 4.1, pikës b), të rregullores Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4, të rregullores zgjedhore 13/2013, të KQZ-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 1 (një) fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të koalicionit PDK-AAK-NISMA, të datës 07.06.2017, thekson se është krejtësisht e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, se gjoja është shkelur Ligji nr.03L/073, neni 33, paragrafi 1, si dhe Rregulla Zgjedhore neni 4.1, b), i Rregullës Zgjedhore 11/2013. Hapësira ku është vendosur pano e kryetarit të PDK-së, është hapësirë reklamuese dhe si e tillë është në shfrytëzim nga N.SH “2 B”, sipas kontratës nr.218/16.06.2016 dhe Qendra e Studenteve e Universitetit të Prishtinës. Ndërmarrja N.SH. “2B”, ka nënkontratë me ndërmarrjen “A.SD-LINE”, nga e cila kemi kontraktuar këtë hapësirë reklamuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e kësaj të fundit. Prandaj pretendimet në ankesën e Vetëvendosjes janë krejtësisht të pabazuar dhe ankesa si e tillë duhet të hudhet poshtë. Këtë e dëshmojmë me kontratat e bashkangjitura këtij kundërshtimi të ankesës Anr.90/2017. Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

**Ankesa është e pabazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se pano e kandidatit për deputet në fushatën zgjedhore e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është vendosur në objektin privat dhe në bazë të kontratës për vendosjen dhe reklamimin në objektet reklamuese Qendra e Studenteve i jep në shfrytëzim N.SH “2B”, të drejtën për vendosjen dhe reklamimin në hapësirat e jashtme, objekteve gjegjësisht Konviktet më nr.2, 3, 4, 5 dhe 7. Në bazë të nenit 2 të kësaj kontrate N.T. “2B” angazhohet për vendosjen e objekteve reklamuese më shpenzimet e veta duke përfshirë edhe pajisjet. Ndërkaq në kontratën e lidhur më datën 01.06.2017, ndërmjet N.SH, “2B” në cilësinë e pronarit dhe “A.S D-Line” në cilësinë e shfrytëzuesit, me pëlqimin e tyre, jep përkatësisht merr në shfrytëzim hapësirën reklamuese me dimensione 12x6 m, në muret e konviktit sipas provave (panos), të cilën N.SH. “2B”, e ka me qira nga Qendra e Studentëve në Prishtinë. Sipas kësaj kontrate palët janë dakorduar, që ta shfrytëzoj hapësirën reklamuese për kampanjën zgjedhore, në vlerë prej 200 euro, në afat prej 10 ditëve, nga dita e lidhjes së kontratës me datë 01.06.2017 deri me 10.06.2017. Nga provat e paraqitura, Paneli konstaton se nuk ka shkelje nga dispozita e nenit 33, pika b), të LPZ-së, si dhe të kodit të mirësjelljes për subjektet politike, andaj në bazë të kësaj refuzoj ankesën si të pabazuar.

Nga të dhënat e cekura si më lart Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c), dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.90/2017 më datën 07.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
**Zyhdi Haziri**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së..